

**LIGJ**  
**Nr.9831, datë 12.11.2007**  
*(ndryshuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009)*

**PËR DËMSPËRBLIMIN E ISH TË DËNUARVE POLITIKË  
TË REGJIMIT KOMUNIST**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

**Objekti dhe fusha e veprimit të ligjit**

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i përfituesve, masës, kriterëve dhe procedurës së përfitimit të dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politikë, të cilët kanë vuajtur persekutimin e drejtpërdrejtë në regjimin komunist, nëpërmjet kryerjes së dënimeve penale të padrejta, si burgim apo masa mjekësore të detyrueshme, si pasojë e një apo disa vendimeve penale të formës së prerë të gjykatave të zakonshme, gjykatave speciale apo të urdhrave të organeve të hetuesisë, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991.

Objekt i këtij ligji është edhe dëmshpërblimi i familjarëve të viktimave, të ekzekutuara apo të pushkatuara padrejtësisht për motive politike, me vendime penale të formës së prerë të gjykatave të zakonshme apo speciale, ose me urdhra të organeve të hetuesisë, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991, si dhe dëmshpërblimi financiar për personat e internuar ose të dëbuar, me kusht që humbja e jetës apo periudha e vuajtjes së internimit ose dëbimit të vërtetohen me dokument, të krijuar si burim arkivor para datës 1.10.1991. Dëmshpërblimi i viktimave, të vrara ose të ekzekutuara gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991, jepet vetëm për familjarët e përcaktuar sipas këtij ligji.

Neni 2

**Qëllimi i ligjit**

*(ndryshuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009)*

Qëllimi i këtij ligji është dhënia e dëmshpërblimit financiar nga shteti shqiptar për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, për familjarët e viktimave të ekzekutuara dhe personat e internuar ose të dëbuar në kampe, si një angazhim i shtetit demokratik në dënimin e krimeve të regjimit totalitar komunist dhe garantimin për ta të një jete më të mirë.

Dëmshpërblimi financiar, sipas këtij ligji, nuk përjashton marrjen e masave të tjera, të njëkohshme ose të mëvonshme, ligjore apo administrative, në dobi të të persektuarve e të dënuarve politikë, të cilat i shërbejnë rivendosjes së drejtësisë dhe dinjitetit shoqëror të kësaj shtrese apo krijimit të kushteve favorizuese, për riintegrimin shoqëror të tyre.

Procedura e shqyrtimit administrativ të kërkesave dhe masa e dëmshpërblimit financiar për familjarët e viktimave të ekzekutuara padrejtësisht pa gjyq, për motive politike, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 01.10.1991, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

### Neni 3

#### **Dënim penal i padrejtë**

*(ndryshuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009)*

Me dënim penal të padrejtë, në kuptim të këtij ligji, për efekt të dëmshpërblimit, nënkuptohet dënimi kapital ose çdo ditë heqje lirie, izolimi, internimi apo dëbimi, për vepra penale politike, në institucionet penitenciare apo një institucion mjekësor, psikiatrik apo jopsikiatrik, për shkak të një:

- a) vendimi apo urdhri hetuesie me vdekje, i ekzekutuar gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991;
- b) vendimi dënim me burgim të përjetshëm;
- c) vendimi dënim me burgim;
- ç) vendimi dënim me mjekim të detyruar;
- d) vendimi dënim me vendosje në një institucion mjekësor apo mjekësor psikiatrik;
- dh) urdhri nga hetuesia;
- e) vendimi dënim me vdekje, i paekzekutuar, si pasojë e rrëzimit të sistemit komunist më 1.10.1991;
- ë) vendimi, urdhri hetuesie apo vendimi administrativ politik për internim ose dëbim;
- f) akti administrativ apo dokumenti zyrtar që provon internimin në kampe me rrethim me tela me gjemba.

### Neni 4

#### **Kriteret për të përfituar dëmshpërblim**

*(ndryshuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009)*

I dënuari ose familjarët e viktimave të dënuara, të ekzekutuara apo të pushkatuara, për të përfituar dëmshpërblim duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë dënuar me dënim kapital, heqje lirie, internim dhe dëbim apo të jetë izoluar në hetuesi ose në një institucion mjekësor psikiatrik, për shkak të një vendimi gjykate të formës së prerë, të një akti administrativ apo të urdhrave të hetuesisë, të dhëna gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991;
- b) heqja e lirisë, izolimi në hetuesi apo në një institucion mjekësor psikiatrik, me vendim gjyqësor të formës së prerë apo me urdhër të hetuesisë, të jetë për shkak të një vepre penale politike, siç përcaktohet në nenin 5 të këtij ligji;
- c) të ketë kryer ose të ketë vuajtur dënim penal të padrejtë plotësisht ose pjesërisht;
- ç) të kenë fituar pafajësinë, sipas ligjit nr. 7541, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar;
- d) sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, të mos ketë kryer veprime të dëmshme, me pasoja për jetën e shtetasve të tjerë gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 01.10.1991.

### Neni 5

#### **Vepra penale politike**

*(ndryshuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009)*

Vepra penale politike, në kuptim të këtij ligji, vlerësohen vetëm veprat penale, të parashikuara në njëri nga dispozitat ligjore të mëposhtme:

- a) në nenin 1 të ligjit nr.21, datë 15.12.1944 “Mbi sabotatorët e luftës dhe të pushtetit të popullit, mbi ata, që fshehin kriminelët e luftës etj., mbi ata që vjedhin pasurinë e shtetit dhe të popullit, mbi spekulatorët, falsifikatorët, mbi ata, që fshehin sende të domosdoshme për ushqimin dhe strehimin e popullit dhe për rindërtimin e vendit”;
- b) në nenet 14, 15, 16, 17 e 18 të ligjit nr.41, datë 14.1.1945 “Mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave ushtarake”;

c) në nenet 2, 3 pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, nenin 4, 6, 7, 8 e 9 të ligjit nr.372, datë 12.12.1946 “Mbi fajet penale kontra popullit dhe shtetit”;

ç) në ligjin nr.373, datë 12.12.1946 “Mbi ndjekjen e tregtisë së ndaluar, të spekulimit dhe sabotimit ekonomik”, pjesa e sabotimit ekonomik, si dhe në nenin 3 të ligjit nr. 1209, datë 10.01.1951 “Mbi mbrojtjen e paqes midis popujve”;

d) dispozitat e mëposhtme të Kodit Penal të vitit 1952:

Neni 64 “Tradhtia ndaj atdheut”

Neni 65 “Spiunazhi”

Neni 69 “Organizimi dhe pjesëmarrja në bandat e armatosura”

Neni 70 “Diversioni”

Neni 71 “Sabotimi”

Neni 72 “Agjitacioni dhe propaganda kundër pushtetit popullor”

Neni 73 “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve midis kombësive, racave ose feve”

Neni 74 “Propaganda e luftës”

Neni 75 “Pjesëmarrja në një organizatë kundër pushtetit popullor”

Neni 82 “Veprimtaria para çlirimit”

Neni 83 “Solidarësia ndërkombëtare”

Nenet 105, 106, 107 e 108 “Krime në lidhje me tatimet dhe detyrimet”. Neni 226 “Moskallëzim i krimit”, paragrafi i parë për moskallëzim të një krimi kundër shtetit, të parashikuar në nenet 64, 69, 70, 71, 72, 74, 75, 82, 83 të këtij Kodi dhe neni 259 “Kalim i paligjshëm i kufijve të shtetit”;

dh) dispozitat e Kodit Penal të vitit 1977, miratuar me ligjin nr.5591, datë 15.6.1977 dhe ndryshuar me ligjin nr. 6300, datë 27.3.1981, të përcaktuar si më poshtë:

Neni 47 “Tradhtia ndaj atdheut”

Neni 48 “Spiunazhi”

Neni 52 “Diversioni”

Neni 53 “Sabotimi”

Neni 55 “Agjitacioni dhe propaganda kundër shtetit”

Neni 57 “Krijimi i një organizate kundërrevolucionare ose pjesëmarrja në të”

Neni 58 “Veprimtaria armiqësore para çlirimit”

Neni 60 “Veprimtaria kundër lëvizjes revolucionare të klasës punëtore”

Neni 112 “Moskallëzim i krimit”, paragrafi i dytë, për moskallëzim të një krimi kundër shtetit, të parashikuar në nenet 47 dhe 60 të këtij Kodi dhe neni 127 “Kalim i paligjshëm i kufijve”;

e) shkelje e dekretit nr.7408 datë 31.7.1990 “Për mbledhjet grumbullimet dhe manifestimet e shtetasve në vende publike”;

ë) shkelje e dekretit nr.7459 datë 22.1.1991 “Për respektimin dhe mbrojtjen e monumenteve që lidhen me historinë kombëtare dhe simbolet shtetërore.”

Kur, në përfundim të një gjykimi, ish i dënuari politik është dënuar me një vendim përfundimtar, të dhënë si bashkim dënimesh, një ose disa prej të cilave janë dënime penale politike të padrejta, në kuptim të këtij ligji, përlllogaritja e pjesës takuese, që zë dënimi politik, për efekt të këtij ligji, në kohën e përgjithshme të vuajtjes së dënimit, të kryhet në përpjesëtim me raportin gjithsej, sipas formulës, që i bashkëlidhet shtojcës “A”. Në të njëjtën mënyrë veprohet në rastet kur bashkimi i dënimeve është dhënë gjatë kohës së vuajtjes së një dënimi të mëparshëm.

Neni 6

### **Masa e dëmshtëpërblimit për të burgosurit, të internuarit ose të dëbuarit politikë**

Masa e dëmshtëpërblimit për të burgosurit, të internuarit ose të dëbuarit politikë do të jetë si më poshtë:

a) çdo i dënuar politik, për çdo ditë vuajtjeje dënimi të kryer, në burg, spital psikiatrik, spital burgu, izolim në hetuesi, nga data 30.11.1944 deri më 1.10.1991, dëmshpërblehet financiarisht, sipas kriterëve të këtij ligji, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në ditë;

b) për personat që kanë vuajtur internim në kamp me rrethim me tela me gjemba deri në vitin 1954, masa e dëmshpërblimit është 1 000 (një mijë) lekë në ditë;

c) për personat e tjerë të internuar ose të dëbuar parashikohet një skemë pensioni, e cila do të rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Dëmshpërblimi i përcaktuar në paragrafin më sipër u takon dhe familjarëve të tij, në pjesë të barabarta takuese, kur i dënuari nuk jeton më. E drejta e familjarëve për të kërkuar dëmshpërblim është e drejtë jopasurore vetjake.

Nga shuma që çdo i dënuar politik përfiton nga ky ligj, zbritet masa e dëmshpërblimit që ai ka përfituar me ligjet e mëparshme.

#### Neni 7

### **Masa e dëmshpërblimit për familjarët e të dënuarve me dënim kapital**

Familjarët e viktimave, të pushkatuara apo të ekzekutuara me dënim politik të padrejtë, për vuajtjen dhe persekucionin, përfitojnë një dëmshpërblim financiar të barabartë, gjithsej, në masën e 8 viteve kompensim dënimi me burgim. E drejta e familjarëve për të kërkuar dëmshpërblim është e drejtë jopasurore vetjake.

#### Neni 8

### **Rrethi i familjarëve sipas këtij ligji**

*(ndryshuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009)*

1. Në kuptim të këtij ligji, me familjarë nënkuptohen, pavarësisht nga rregullime të tjera ligjore, paraardhësit, bashkëshortja, pasardhësit, vëllezërit dhe motrat e ish të dënuarit politik, si dhe fëmija/fëmijët e vëllezërve dhe motrave.
2. Familjarët, në shkallë më të parë, sipas Kodit Civil, përjashtojnë familjarët e tjerë.

#### KREU II

### **AUTORITETI PËRGJEGJËS DHE KRITERET, NË BAZË TË TË CILAVE KRYHET SHPËRNDARJA E DËMSHPËRBLIMIT**

#### Neni 9

### **Autoriteti përgjegjës për miratimin e dëmshpërblimit**

Këshilli i Ministrave është autoriteti përgjegjës që miraton dëmshpërblimin financiar, në përputhje me këtë ligj, i cili, me vendim, përcakton gjenealitetet përkatëse të ish të dënuarit politik, llojin e dënimit, periudhën e plotë të vuajtjes së dënimit, gjithsej, në vite, muaj dhe ditë, sipas rastit, shumën e dëmshpërblimit financiar dhe, sipas rastit, gjenealitetet e sakta të familjarëve të viktimave të pushkatuara dhe masën përkatëse të dëmshpërblimit të tyre.

#### Neni 10

### **Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave**

1. Ministria e Drejtësisë është autoriteti përgjegjës që shqyrton kërkesat për përfitimin e dëmshpërblimit, sipas këtij ligji, në përputhje me rregullat e përcaktuara në kreun V të këtij ligji. Kur, pas shqyrtimit administrativ, rezulton se kërkesa është e drejtë dhe e bazuar në ligj, Ministria e Drejtësisë i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e dëmshpërblimit.

2. Këshilli i Ministrave shqyrton propozimet e dërguara nga Ministria e Drejtësisë brenda dy javëve kalendarike. Vendimet hyjnë në fuqi menjëherë dhe botohen në Fletoren Zyrtare.

## Neni 11

### **Autoritetet përgjegjëse për bashkërendimin e punës**

1. Ministria e Drejtësisë, gjatë shqyrtimit të kërkesave, bashkërendon punën me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, Shërbimin Informativ të Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shtetit dhe arkivat e sistemit gjyqësor.

2. Kriteret, procedurat e bashkërendimit të informacionit dhe lloji i përgjigjes për çdo kërkesë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Ministria e Brendshme, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, depoziton në Ministrinë e Drejtësisë kopje të njësuara të arkivit për dënimet me internim ose dëbim.

## Neni 12

### **Kriteret për shpërndarjen e fondit**

*(ndryshuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009)*

Në bazë të buxhetit vjetor, të vënë në dispozicion dhe sipas radhës së caktimit të dëmshpërblimit, fondet do të ndahen në mënyrë proporcionale për të gjithë ish të dënuarit dhe familjarët e viktimave të pushkatuara, me kusht që vlera e dëmshpërblimit gjatë fazës së parë të mos jetë më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.

I njëjti mekanizëm do të përsëritet një ose më shumë herë, deri në shpërndarjen e plotë të shumës së dëmshpërblimit për të gjithë ish të dënuarit/familjarët e viktimave, me kusht që, në çdo rast, pjesa takuese që kompensohet të mos jetë më e vogël se 100 000 (njëqind mijë) lekë. Asnjë ish i dënuar apo familjar i tij nuk mund të dëmshpërblehet jashtë këtij mekanizmi.

## Neni 13

### **Shpërndarja e dëmshpërblimit**

1. Ministria e Drejtësisë, brenda 1 jave nga miratimi në Këshillin e Ministrave të vendimit për dëmshpërblimin, i përcjell Ministrisë së Financave kopjen e plotë të dosjeve individuale të ish të dënuarve politikë, që përfitojnë dëmshpërblim, sipas këtij ligji.

2. Ministria e Financave, sipas buxhetit të vënë në dispozicion, shpërndan, në vlerë të plotë, dëmshpërblimin, për çdo të dënuar politik, që përfiton sipas këtij ligji, nëpërmjet çeljes së depozitës bankare, në emër dhe/ose për llogari të tij ose të familjarëve të tij, në një bankë të nivelit të dytë. Dokumenti i çeljes së llogarisë bankare i bashkëlidhet dosjes në Ministrinë e Financave.

3. Ministri i Financave urdhëron shpërndarjen e dëmshpërblimit, sipas radhës së përparësisë së caktuar në nenin 12 të këtij ligji.

## Neni 14

### **Tërheqja e dëmshpërblimit nga llogaritë**

*(ndryshuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009)*

Dëmshpërblimi financiar, i depozituar në llogaritë bankare, tërhiqet personalisht nga vetë ish i dënuari politik apo nga kujdestari i tij ligjor, kur ai ka humbur zotësinë juridike për të vepruar, apo nga familjari i viktimës së ekzekutuar.

Kur ish i dënuari politik ka vdekur ose vdes pas depozitimit të kërkesës në Ministrinë e Drejtësisë, familjarët e përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji, për çeljen e depozitës bankare, duhet të depozitojnë në Ministrinë e Financave këtë dokumentacion:

- a) certifikatën e vdekjes së ish të dënuarit politik;
- b) dëshminë e trashëgimisë së ish të dënuarit politik;

c) kopje të vlefshme të dokumentit të identitetit;

d) certifikatën e trungut familjar.

Kur trashëgimtarët, sipas këtij ligji, e kanë deleguar me prokurë/akt njërit prej tyre, veprimet nga Ministria e Financave bëhen në emër të personit me këtë të drejtë.

Neni 15

### **Çelja e depozitës dhe njoftimi**

*(ndryshuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009)*

Depozitat bankare, që çelen në emër të ish të dënuarit politik apo familjarëve përfitues, sipas nenit 14 të këtij ligji, bëhen të disponueshme brenda 1 jave kalendarike nga çelja e tyre. Ministria e Financave njofton publikisht në media dhe nëpërmjet faqes së vet zyrtare për çeljen e llogarive. Ky njoftim shpallet edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, në arkivin për këtë çështje.

Neni 16

### **Afati i vlefshmërisë së depozitës**

Depozitat e çelura, në përputhje me nenin 15 të këtij ligji, janë të kërkueshme 3 vjet nga çelja e tyre. Kur brenda 3 vjetëve pranë bankës nuk paraqitet asnjë i interesuar, apo kur të interesuarit nuk plotësojnë kriteret e caktuara në nenin 14 të këtij ligji, llogaria transferohet drejtpërdrejt në thesarin e shtetit, sipas një rakordimi paraprak, të kryer nëpërmjet bankës së nivelit të dytë dhe Ministrisë së Financave.

## **KREU III**

### **MBIKËQYRJA E MËNYRËS SË SHPËRNDARJES SË ÇDO DËMSHPËRBLIMI**

Neni 17

### **Mbikëqyrja nga Kuvendi**

Kuvendi, me një komision të posaçëm, brenda 3-mujorit të parë të çdo viti, verifikon mënyrën e shpërndarjes së dëmshpërblimit nga Ministria e Financave, në përputhje me kriteret e caktuara në nenin 12 të këtij ligji.

Ministri i Financave vë në dispozicion të Kuvendit, brenda datës 17 janar të çdo viti, dokumentet e vitit pararendës. Komisioni, sipas informacionit të Ministrisë së Financave, i raporton Kuvendit brenda 15 ditëve nga ngritja e tij.

Neni 18

### **Mbikëqyrja nga Ministria e Financave**

Ministria e Financave, në përputhje me legjislacionin bankar në fuqi dhe me këtë ligj, mbikëqyr zbatimin e neneve 14, 15 e 16 të këtij ligji nga bankat e nivelit të dytë, që ofrojnë këtë shërbim, sipas përzgjedhjes.

Brenda datës 27 janar të çdo viti, Ministria e Financave raporton në komisionin e posaçëm të Kuvendit, me shkrim, informacion për shpërndarjen e depozitave dhe ecurinë e këtij procesi gjatë vitit pararendës.

## **KREU IV**

### **FILLIMI I PROCEDURËS PËR KËRKESËN PËR DËMSHPËRBLIM**

## Neni 19

### **Afati i paraqitjes së kërkesës dhe autoriteti** (ndryshuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009)

1. Brenda datës 01.07.2009, ish të dënuarit politikë, drejtpërdrejt apo nëpërmjet kujdestarit ligjor, si dhe familjarët e viktimave të ekzekutuara, që plotësojnë kriteret e neneve 4 e 5 të këtij ligji, paraqesin në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën me shkrim për përfitimin e dëmshpërblimit financiar, për dënimin penal të padrejtë, sipas formularit të paraqitur në aneksin "A", që i bashkëlidhet këtij ligji.

2. Mosparaqitja e kërkesës brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, sjell humbjen e së drejtës së dëmshpërblimit për ish të dënuarin politik apo familjarin e viktimës me dënim kapital. Sipas këtij ligji ish i dënuari politik i regjimit komunist, kujdestari i tij ligjor apo familjari i viktimës së pushkatuar nuk mund të rivendosen në afat, për paraqitjen e kërkesës, pas datës 1.7.2009.

## Neni 20

### **Përmbajtja e kërkesës** (ndryshuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009)

Kërkesa për dëmshpërblim duhet të përmbajë:

a) të dhëna për përbërësit e gjendjes civile të ish të dënuarit politik, në kohën e dënimit dhe informacion aktual, sipas rastit, nëse janë ndryshuar emri, mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, seksi, raportet e atësisë e të mëmësisë për të dënuarit me vdekje, burgim, internim ose dëbim. Për të gjitha ndryshimet në përbërës, kërkesës duhet t'i bashkëlidhet edhe akti, që i ka ndryshuar ato;

b) të dhëna për periudhën e ekzekutimit (ditën)/vuajtjen e dënimit/dënimeve, hyrjedaljet nga burgimi, izolimi, internimi apo dëbimi;

c) vendimin e gjykatës, të formës së prerë/aktin e internimit, aktin administrativ apo dokumentin zyrtar që provon internimin në kampe me rrethim me tela me gjemba, apo aktakuzën për izolim, nëse ka;

ç) dokumentacionin për gjendjen familjare aktuale të ish të dënuarit politik;

d) çdo informacion, që ka ai për gabime ortografike apo materiale të përbërësve të gjendjes civile të tij, në vendim apo aktakuzë, për identifikimin e saktë të tij;

dh) certifikatën e gjendjes civile, që provon të gjithë përbërësit e gjendjes civile dhe një adresë të saktë, të zgjedhur prej tij për komunikim.

Certifikata duhet të jetë lëshuar jo më vonë se 45 ditë nga dorëzimi i kërkesës.

Për ish të dënuarit, që nuk jetojnë, apo familjarët e viktimave, kërkesa paraqitet nga familjari, sipas rrethit të përcaktuar në këtë ligj. Në këto raste kërkuesi paraqet dokumentacionin që provon lidhjen familjare me ish të dënuarin politik, si dhe dokumentacionin që provon se cilët nga familjarët përfitues të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji janë të gjallë.

## Neni 21

### **Mënyra dhe evidentimi i kërkesave**

Paraqitja e kërkesës në Ministrinë e Drejtësisë kryhet brenda territorit të vendit, vetëm me anë të Postës Shqiptare sha, nëpërmjet dorëzimit nga kërkuesi të dokumentacionit dhe marrjes së lajmërimit nëpërmjet postës për lajmërim-marrjen nga ministria. Çdo ish i dënuar politik i regjimit komunist, familjar i viktimave të pushkatuara ose familjar brenda rrethit të caktuar në këtë ligj i të dënuarit politik, që jeton ose nuk jeton, dorëzon dokumentet në emër të të dënuarit politik, i deklaron punonjësit të postës qëllimin e dërgesës dhe pajiset prej tij me formularin tip, që i bashkëlidhet këtij ligji, ku shënohen numri i dokumenteve të dorëzuara, data dhe ora e pranimit të kësaj dërgese dhe numri i regjistrimit të saj. Formulari nënshkruhet

nga punonjësi i postës dhe dërguesi në tri kopje, për dërguesin, për postën dhe për Ministrinë e Drejtësisë. Posta Shqiptare sha regjistron çdo dërgesë të saj në regjistra të veçantë dhe i ruan ato, sipas legjislacionit në fuqi.

Dokumentacioni i dërguesit, së bashku me kopjen e formularit, për Ministrinë e Drejtësisë, i postohet kësaj të fundit. Një kopje e njoftimit të marrjes së dokumenteve i përcillet dërguesit.

Tarifa e këtij shërbimi postar, e reduktuar, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe shërbimi kryhet në të gjitha filialet postare të qyteteve dhe të bashkive të vendit. Për të dënuarit me vendndodhje jashtë vendit, dorëzimi i dokumenteve në Ministrinë e Drejtësisë kryhet drejtpërdrejt, nëpërmjet shërbimit konsullor, sipas së njëjtës procedurë, të përcaktuar në paragrafin e dytë të këtij neni, ku punonjësi konsullor kryen pranimin dhe harton formularin e dorëzimit të dokumentacionit. Kërkesat, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, i përcillen Ministrit të Drejtësisë. Tarifa e këtij shërbimi përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

Posta Shqiptare sha dhe shërbimi konsullor, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit 1-vjeçar, dorëzojnë në Këshillin e Ministrave të dhëna për numrin e dërgesave të kryera. Një kopje e këtij informacioni i përcillet edhe Kontrollit të Lartë të Shtetit. Kur, pas plotësimit të afatit 1-vjeçar, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ka pretendime nga ish të dënuar politikë, familjarë të viktimave të pushkatuara, se kanë dorëzuar dokumentet, por ato nuk gjenden, kanë humbur, kanë të meta të pjesshme etj., mjeti i vetëm provues, që shërben për pranimin e këtij pretendimi, është formulari i trefishtë i dorëzimit në postë apo në shërbimin konsullor. Ministri i Drejtësisë urdhëron ripranimin e dokumenteve, edhe pas plotësimit të afatit 1-vjeçar, sipas këtij ligji, vetëm kur kërkuesi provon se i ka dorëzuar ato në postë apo në shërbimin konsullor.

#### Neni 22

### **Evidentimi dhe krijimi i regjistrit elektronik në ministri**

Të gjitha kërkesat, të mbërritura nëpërmjet Postës Shqiptare sha apo shërbimit konsullor regjistrohen dhe evidentohen në librat e hyrjes në ministri, në emër të personit të dënuar politik, që aplikon për përfitimin e dëmshpërblimit.

Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë, në faqen e vet zyrtare, publikon gjenealitetet e çdo kërkuesi, që aplikon për përfitimin e dëmshpërblimit, sipas këtij ligji. Të dhënat e këtij regjistri përditësohen çdo javë, në mënyrë periodike.

#### KREU V

### **PROCEDURA E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE, HETIMI**

#### Neni 23

### **Fillimi i shqyrtimit të kërkesave**

*(ndryshuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009)*

Ministria e Drejtësisë kryen shqyrtimin e çdo kërkesë, të përcjellë nga të ish të dënuarit politikë, nëpërmjet Postës Shqiptare sha dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, sipas nenit 19 të këtij ligji.

Pas datës 1.7.2009, pasi janë kryer rakordimet përkatëse ndërmjet Postës Shqiptare sha, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Drejtësisë, Ministri i Drejtësisë raporton pranë Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit numrin e kërkesave totale të paraqitura për dëmshpërblim, sipas këtij ligji dhe diferencat, kur ka të tilla.



## Neni 24

### Veprimet paraprake

Ministria e Drejtësisë, pas regjistrimit të kërkesës, hap dosjen individuale dhe brenda 10 ditëve vepron si më poshtë:

a) kur nga shqyrtimi paraprak vëren se kërkesa nuk shoqërohet me dokument provues, e njofton kërkuuesin për të plotësuar dokumentet brenda një afati 30-ditor, duke i dhënë informacion për zyrën shtetërore se ku mund t'i gjejë këto dokumente;

b) kur nga shqyrtimi paraprak provon se i dënuari politik nuk është gjallë dhe kërkesa nuk kryhet nga rrethi i familjarëve, të përcaktuar në këtë ligj, i dërgon njoftim negativ dërguesit në adresën e tij. I njëjti veprim kryhet edhe për familjarët e viktimave të pushkatuara, kur provohet se familjarët brenda rrethit të caktuar në këtë ligj nuk jetojnë më;

c) kur nga shqyrtimi paraprak provon se lloji i dënimit nuk përbën shkak për përfitimin e dëmshpërblimit, sipas këtij ligji, dërgon njoftim negativ në adresën e dërguesit;

ç) shqyrton në themel të gjitha kërkesat e tjera, që plotësojnë kriteret formale të këtij ligji.

Veprimet administrative, të përmendura në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të këtij neni, evidentohen me shkrim dhe i njoftohen menjëherë kërkuuesit ose dërguesit, duke argumentuar shkakun ligjor përkatës. Një kopje e njoftimit, sipas rastit, administrohet në dosjen individuale përkatëse. Ministria e Drejtësisë, për të gjitha njoftimet lajmëron kërkuuesin edhe për adresën zyrtare, ku duhet të dërgojë dokumentet me postë apo nëpërmjet shërbimit konsullor. Në të gjitha rastet kërkuuesit kanë të drejtë të ofrojnë e të sjellin prova, për të kundërshtuar njoftimin negativ. Korrespondenca, në këtë rast, do të jetë e njëjtë, si në rastin e dërgimit të kërkesës me postë.

Në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë evidentohen çdo javë kalendarike veprimet paraprake për çdo kërkesë të regjistruar.

Kur, brenda një afati 60-ditor nga marrja e njoftimit negativ, në adresën e Ministrisë së Drejtësisë nga kërkuesi nuk paraqitet asnjë pretendim për çështjen apo pretendimi nuk provohet, Ministri i Drejtësisë urdhëron mosmiratimin e kërkesës. Urdhri shoqërohet me relacionin përkatës.

## Neni 25

### Mënyra e shqyrtimit të kërkesave

Shqyrtimi i kërkesave për përfitimin e dëmshpërblimit, sipas nenit 28 të këtij ligji, kryhet nëpërmjet shqyrtimit të drejtpërdrejtë dhe të bashkërenduar. Ministri i Drejtësisë vendos pranimin e një kërkesë vetëm kur, nga shqyrtimi i drejtpërdrejtë dhe i bashkërenduar, kërkesa plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.

## Neni 26

### Shqyrtimi i drejtpërdrejtë

Shqyrtimi i drejtpërdrejtë është faza e parë e hetimit, i cili kryhet në sektorin e gjendjes gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë (skedarët e përgjithshëm dhe ato të posaçëm, për të përndjekurit politikë të regjimit komunist) dhe, sipas rastit, në arkivin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Çdo kërkesë i nënshtrohet këtij shqyrtimi, pavarësisht informacionit provues, që i bashkëlidhet dosjes. Kopja e ekstrakteve të arkivit printohet, nënshkruhet nga punonjësi, që përpunoi informacionin dhe i bashkëlidhet dosjes së kërkuuesit. Informacioni, për çdo kërkesë, kërkohet në të gjitha variantet emër, mbiemër, viti i lindjes, lloji i veprës penale etj., përfshi edhe indicjet për gabime të mundshme, ortografike dhe materiale, të dhëna nga vetë kërkuesi, për gjenealitetet e tij. Pas verifikimit të drejtpërdrejtë të informacionit, punonjësi vepron si më

poshtë:

a) kur provohet se kërkuesi ka kryer vetëm dënim penal politik, ai evidenton, në një formular të posaçëm, llojin dhe, sipas rastit, kohën e vuajtjes së dënimit, gjithsej, të cilin ia bashkëlidh dosjes. Dosja i përcillet për shqyrtim të bashkërenduar organeve të tjera shtetërore, për të parë nëse çështjet janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në shkronjën “d” të nenit 4 të këtij ligji;

b) kur provohet se kërkuesi, gjatë të njëjtit gjykim apo gjatë gjykimeve të tjera, është dënuar për një ose më shumë vepra penale, politike dhe jopolitike, ai evidenton llojin dhe, sipas rastit, kohën e saktë të vuajtjes së dënimit, gjithsej, politik dhe jopolitik, në një formular të veçantë, që i bashkëlidhet dosjes. Në vijim dosja u përcillet për shqyrtim të bashkërenduar organeve të tjera shtetërore, për të parë nëse çështjet janë sipas kriterëve të përcaktuara në shkronjën “d” të nenit 4 të këtij ligji;

c) kur provohet se kërkuesi, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, ka kryer veprime me pasoja për jetën e shtetasve të tjerë, i propozon ministrit ta klasifikojë kërkesën si të pabazuar në këtë ligj;

ç) kur provohet se kërkuesi ka kryer vetëm dënime jopolitike, i propozon ministrit ta klasifikojë atë si të pabazuar në këtë ligj;

d) kur provohet se Ministria e Drejtësisë nuk ka të dhëna për kërkuesin, kërkesa i përcillet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit për verifikim të drejtpërdrejtë në burimet e tyre arkivore të periudhës 30.11.1944 - 1.10.1991. Autoritetet përgjegjëse, brenda 30 ditëve, verifikojnë kërkesën dhe dërgojnë informacion në Ministrinë e Drejtësisë edhe për çështje të përmendura në shkronjën “d” të nenit 4 të këtij ligji. Brenda 5 ditëve, Ministria e Drejtësisë e kualifikon kërkesën:

i) në njërën ndër veprimet e përcaktuara në shkronjat “a” deri në “ç” të këtij neni;

ii) në rubrikën “Të dhëna për kërkuesin nuk ka”.

Kur kërkesa kualifikohet sipas nënndarjes “ii” të shkronjës “d” të këtij neni, punonjësi i propozon ministrit ta klasifikojë si të pabazuar në këtë ligj, për mungesë provash.

Në kuptim të këtij neni, shprehja kërkues i referohet subjektit, që ka kryer dënim politik me burgim, internim, dëbim apo është ekzekutuar.

#### Neni 27

### **Shqyrtimi i bashkërenduar**

Shqyrtimi i bashkërenduar është faza e dytë e hetimit, të cilit i nënshtrohen kërkesat që rezultojnë dënime politike, në kuptim të këtij ligji. Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, brenda afatit 30-ditor, shqyrtojnë kërkesat dhe, me njoftim individual, shprehet secili, nëse i dënuari politik plotëson kriteret e përcaktuara në shkronjën “d” të nenit 4 të këtij ligji. Informacionet e bashkërenduara depozitohen në dosje. Punonjësi përgjegjës, në përputhje me nenin 28 të këtij ligji, përgatit relacionin, të cilin ia paraqet Ministrit të Drejtësisë.

#### Neni 28

### **Zhvillimi i hetimit**

Struktura përgjegjëse në ministri, brenda 35 ditëve, shqyrton në themel të gjitha kërkesat që, pas shqyrtimit paraprak, janë kualifikuar se plotësojnë kërkesat sipas shkronjës “ç” të nenit 24 të këtij ligji.

Brenda afatit të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, struktura përgjegjëse në ministri verifikon dokumentacionin, sipas neneve 3 e 5 të këtij ligji, harton relacionin përkatës dhe i propozon ministrit pranimin e kërkesës, si të bazuar në ligj ose mospranimin e saj.

Kur propozohet pranimi i kërkesës, akti i propozimit, i nënshkruar nga punonjësi përgjegjës, përmban edhe periudhën e saktë, në ditë, muaj dhe vite të dënimit të kryer, si dhe

masën në lekë të dëmshpërblimit, që do t'i jepet, sipas ligjit.

Ministri i Drejtësisë, në mbështetje të propozimit të strukturës përgjegjëse, urdhëron pranimin apo refuzimin e saj, kur kërkesa nuk mbështetet në ligj. Aktet nënligjore të Ministrisë të Drejtësisë shpallen edhe në faqen zyrtare të ministrisë.

Neni 29

### **Miratimi i kërkesës**

Ministri i Drejtësisë, sipas dispozitave të këtij ligji, vendos miratimin apo refuzimin e kërkesës, i cili është i formës së prerë.

Brenda 10 ditëve, Ministri i Drejtësisë paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave propozimet për përfitimin e dëmshpërblimit, sipas këtij ligji, të cilave u bashkëlidhen relacionet përkatëse.

## **KREU VI**

### **TRANSPARENCA E PROCESIT**

Neni 30

### **Mbikëqyrja nga grupimet e interesit**

Grupimet joqeveritare të ish të dënuarve politikë kanë të drejtë të paraqesin pretendime konkrete, për çështje të moszbatimit të këtij ligji, apo të denoncojnë raste përfitimesh pa të drejtë.

Brenda 10 ditëve, Ministri i Drejtësisë shqyrton çështjen dhe vë në dijeni grupimin joqeveritar, Këshillin e Ministrave dhe komisionin përgjegjës për çështje të të drejtave të njeriut në Kuvend, për çdo pretendim të paraqitur sipas paragrafit të parë të këtij neni.

Raporti me shkrim i Ministrisë të Drejtësisë shoqërohet me kopje të dokumentacionit provues.

Neni 31

### **Denoncimi i fakteve të pavërteta**

Çdo qytetar, në mënyrë individuale apo në grup, ka të drejtë të denoncojë të dhëna të rreme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në ecurinë e procesit të përfitimit të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë të regjimit komunist.

Ministri i Drejtësisë shqyrton çdo denoncim të rastit. Përgjigjja e verifikimit bëhet publike në faqen zyrtare të ministrisë, edhe nëse hartuesi i saj është anonim.

## **KREU VII**

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 32

### **Fondet për zbatimin e këtij ligji**

*(ndryshuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009)*

Në ligjin e buxhetit planifikohen fondet vjetore për zbatimin e këtij ligji. Këshilli i Ministrave, brenda vitit 2009, miraton afatet dhe skemën e shpërndarjes së fondeve.

Neni 33

### **Përzgjedhja e bankës së nivelit të dytë**

Ministri i Financave, në bazë të fondit buxhetor të planifikuar, organizon, brenda 3-mujorit të fundit të çdo viti, procedurën e përzgjedhjes së bankës/bankave të nivelit të dytë, të

cilat do të realizojnë shërbimin e shpërndarjes së depozitave për dëmshpërblimet që do të shpërndahen në vitin në vijim. Fitues është subjekti bankar, që ofron shërbimin më të mirë, sipas kushteve të përcaktuara nga Ministri i Financave.

Neni 34  
**Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të dispozitave të këtij ligji.

Në përputhje me parimet e rivendosjes së të drejtave, të barazisë para ligjit dhe të procesit të rregullt ligjor, ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktin nënligjor në bazë të nenit 2 të ligjit.

**DISPOZITA TRANZITORE**  
*(shtuar me ligjin nr. 10 111, datë 2.4.2009)*

1. Kërkesit që kanë paraqitur kërkesë për përfitimin e dëmshpërblimit financiar në Ministrinë e Drejtësisë, dhe janë njoftuar me “njoftim negativ” në përputhje me shkronjat “b)” dhe “c)” të nenit 24 “Veprimet paraprake” të këtij ligji, kanë të drejtë të riparaqesin kërkesë të re për të rikonfirmuar vullnetin e tyre, si dhe çertifikatën e lindjes të lëshuar jo më vonë se 45 ditë nga dorëzimi i kësaj kërkesë të dytë, të cilat i bashkëlidhen dokumentacionit të paraqitur prej tyre.
2. Pas regjistrimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë fillon procedurën e shqyrtimit administrativ për përfitimin e dëmshpërblimit financiar.
3. Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë rivlerëson edhe njëherë kërkesat e paraqitura për dëmshpërblim financiar për ish të dënuarit politikë, të cilat preken nga ndryshimi i nenit 4 shkronja “d”.

**Neni**

Ministria e Drejtësisë fillon procedurën e shqyrtimit administrativ për të gjitha kërkesat për përfitimin e dëmshpërblimit financiar, të paraqitura pas datës 19.12.2008.

Neni 35  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5527, datë 30.11.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.